

TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Nentor 2020

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000
Komision në hyrje	0%
Komision në dalje	0%
Komision Administrimi në vit	1.25%
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.


Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilin të Rrezikut dhe Përfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.


Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.11.2020

Vlera Neto e Aseteve	42,386,909,421
Numri i investitoreve	23,765
Cmimi i Kuotes	1,537.1969
*Kthimi vjetor nga investimi (30.11.2019 - 30.11.2020)	1.05%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Nentor 2020



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar.

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti

Ne % te Aseteve te Fondit

Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	4.07%
Depozita & Llogari rrjedhese	3.99%
Bono Thesari	23.46%
Obligacione Thesari	68.48%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 42.4 miliardë në datë 30 Nentor 2020.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Nentor

Gjate muajit Nentor tregjet nderkombetare te kapitalit dhe ekonomia boterore vazhduan procesin e rikuperimit nga situata e veshtire financiare e krijuar gjate pandemise globale. Edhe ne vendin tone ka patur një gjallerim te aktiviteteve ekonomike por gjithashtu edhe raste te shtuara me Covid-19 për shkak të ekspozimit më të lartë ndaj virusit dhe përhapjes së tij në të gjitha qytetet.


Asetet e Fondit Prestigj jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve. Keshtu investimet e fondit nuk kane lidhje direkte me tregjet nderkombetare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet ne tregun e brendshem sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise Shqiptare.

Pergjate muajit Nentor ne tregun vendas normat e interesit te titujve te emtuar nga Qeveria Shqiptare pergjithesisht paten nje rritje te lehte. Norma e bonos se thesarit 12 mujore u rrit ne krahesim me muajin e kaluar. Nderkohe qe norma e obligacionit 2 vjecar mbeti e pandryshuar.

Yield-i mesatar i ponderuar ne ankandin primar per Bono Thesari 12-mujore rezultoi ne 1.811%, duke u rritur me 0.08% krahesuar me normen e vendosur ne ankandin e fund muajit Tetor qe ishte 1.727%.

Persa i perket ankandeve te obligacioneve, u zhvillua ankandi i obligacionit 2 vjecar-i i emtuar ne LEK dhe rezultoi ne 2.40%, njesoj sa norma e ankandit te muajit Tetor; Rritjen me te larte e pesoi yieldi i obligacionit reference 5-vjecar i emtuar ne LEK, i cili rezultoi ne 4.20%, duke u rritur me 0.16% ne yield krahesuar me ankandin e fundit qe ishte organizuar ne Shtator.

Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emtuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjecare Nentor 2019 – Nentor 2020. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjecare jane paraqitur yields fiks te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Nentor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 30 Nentor 2020

Çmimi i kuotes se fondit Prestigj ne muajin Nentor ka patur nje rritje te lehte me 0.05%.


Kthimi vjetor neto per periudhen 30 Nentor 2019 – 30 Nentor 2020 eshte i kenaqshem ne nivelin 1.05%.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Prestigj



Ne dt 30 Nentor 2020	1 Vit	3 Vjet	5 Vjet	7 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (1 Mars 2012)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	1.05%	2.32%	3.85%	4.32%	5.03%

Kthimi vjetor historik per cdo vit i Fondit Raiffeisen Prestigj



Fondi Prestigj vijon te kete te njejten strukture te portofolit te investimeve duke investuar ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise. Per pasoje vlere e portofolit te investimit dhe norma e kthimit pesojne luhatje sa here ka ndryshime ne kushtet e tregut, sic jane ndryshime te normave te interesit te bonove / obligacioneve te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlere e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Ne kete menyre çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshe e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

Investoret e fondit Prestigj dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituruar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter. Investoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.